

"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj 4365/22-1

Tuzi, 15. 12 20.22 god.



Pijace / sh.p.k Tuz
d.o.o Tuzi Tregu

SHPK "PIJACE / TREGU" TUZ

**PROGRAMI
I KRYERJES SË VEPRIMTARIVE KOMUNALE
PËR VITIN 2023**

Tuz, dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

I	Hyrje
II	Të dhënat themelore mbi ushtruesin e veprimtarive komunale <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dhënat themelore identifikuese ▪ Forma e organizimit ▪ Aktet themeluese ▪ Cështjet juridike - statusore ▪ Struktura e pronësore ▪ Organizimi i brendshëm dhe skema organizative ▪ Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit të veprimtarive komunale ▪ Organet e udhëheqjes dhe drejtimit
III	Kapacitetet e ushtruesit të veprimtarive komunale <ul style="list-style-type: none"> ▪ Resurset njerëzore ▪ Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale ▪ Pajisjet dhe parku i makinave
IV	Qëllimet e ushtruesit të veprimtarive komunale <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i krejt veprimtarisë ▪ Realizimi i bashkëpunimit me organet, shërbimet publike dhe organizatat e tjera që kanë ndikim në zbatimin e këtij Programi
V	Bazat për përpilimin e Programit
VI	Planifikimi i aktivitetit fizik
VII	Treguesit e planifikuar financiarë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ardhurat e planifikuara ▪ Shpenzimet e planifikuara ▪ Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve
VIII	Politika e rrogave dhe punësimit
IX	Borxhi
X	Plani i prokurimit publik
XI	Politika e çmimeve
XII	Vërejtjet përfundimtare

I HYRJE

Aprovimi i Programit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale parashikohet me dispozitat e nenit 26 paragrafi dhe nenit 29 paragrafi 2 pika 7 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19) si dhe me Regulloren mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20).

Veprimtaria komunale e mirëmbajtjes së tregjeve si dhe krejt veprimaria e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz në vitin 2023 do të kryhet në përputhje me rregulloret e mëposhtme:

Ligjet themelore

- Ligji mbi shoqëritë afariste ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 65/20, 146/21);
- Ligji mbi punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 08/21, 59/21, 68/21, 145/21);
- Ligji mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22);
- Ligji mbi prokurimet publike ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19);
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 34/14, 44/18);
- Ligji mbi pagat e punonjësve të sektorit public ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 16/16, 83/16, 21/17, 42/17, 12/18, 39/18, 42/18, 34/19);
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/14, 06/14, 43/15, 70/17, 67/19, 146/21);
- Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 47/08, 04/11, 22/17);
- Ligji mbi pronën shtetërore ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 21/09, 40/11);
- Ligji për fiskalizimin në qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 46/19, 73/19, 08/21);
- Ligji për tregtinë e brendshme ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 49/08, 40/11, 38/19).

Rregulloret e vetëqeverisjës lokale të Tuzit

- Vendimi mbi rëndin komunal të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19);
- Vendimi mbi tregje ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19);

- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21);
- Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz mbi të cilin Kuvendi Komunal i Tuzit dha pelqimin nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21).

Me këtë Program, Shoqërisa me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz planifikon shërbimin e shpenzimeve individuale komunale, duke dhënë në qira vendet e shitjes që gjenden në objektet e Shoqërisë dhe prej tyre planifikoj të realizoj të ardhurat (Tregu i mallrave të përziera dhe Tregu i gjelbër).

Me këtë Program, Shoqërisa me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, do të planifikojë që me mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe cilësore të objekteve të saj të kujdeset për të siguruar interesin publik dhe stabilitetin afarist.

II TË DHËNAT THEMELORE MBI USHTRUESIN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

Në këtë pjesë të Programit, do japim të dhëna dhe informacione themelore lidhur me SHPK "Pijace/Tregu" Tuz si ushtrues i veprimtarisë komunale të mirëmbajtjes së objekteve të tregut.

II/1 Të dhënat themelore identifikuese

Ushtruesi i veprimtarisë komunale është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. Numri amë i Shoqërisë është 03399109.

Themeluesi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz është Kuvendi i Komunës së Tuzit, numri amë 02628988 me seli në Tuz.

II/2 Forma e organizimit

Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.

II/3 Aktet themeluese

Aktet themeluse të Shoqërisë janë Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021) dhe Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021, mbi të cilin

Kuvendi i Komunës së Tuzit dha pelqimin me Vendim nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 (“Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 46/21).

II/4 Çështjet juridike - statusore

Statusi juridik i Shoqërisë rregullohet me aktin themelues, d.m.th. me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) dhe Statut të SHPK “Pijace/Tregu” Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021.

II/5 Struktura pronësore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pijace/Tregu” Tuz është themelua nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe dhe si e tillë është në pronësi të Komunës së Tuzit.

II/6 Ogranizimi i brendshëm dhe skema organizative

Në pajtim me Rregulloren aktuale mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, format bazë të organizimit të Shoqërisë janë sektoret, dhe ato janë:

- Sektori për çështje teknike - operative dhe
- Sektori për çështje ekonomike - juridike.

Njësitë organizative në përbërjen e tyre përmbajnë shërbime dhe reparte.

II/7 Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit së veprimtarive komunale

Veprimtaritë kryesore dhe dytësore që Shoqëria kryen dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Statuti i Shoqërisë përcakton veprimtarinë bazë që kryen Shoqëria, e cila është me interes publik dhe është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste me kodin 8299:

- ndërton, mirëmban dhe menaxhon objektet e tregut;
- ruan higjienën e përgjithshme në zonën e tregut dhe objektet tjera në pronësi të komunës së Tuzit;
- kryen punë të tjera në interesin publik.

Krahas këtyre aktiviteteve, Shoqëria kryen edhe veprimtari që nuk kanë karakter të aktiviteteve me interes publik, përkatësisht:

- përgatit dhe zbaton programe në fushën e investimeve;

- investimi në ndërtimin e objekteve me investim të përbashkët me investitorë të tjerë;
- marrja me qira e pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme.

II/8 Organet e udhëheqjes dhe drejtimit

Shoqërinë e udhëheq Themeluesi në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë në bazë të Statutit të Shoqërisë, me ç'gjë sigurohet interesi publik.

Kuvendi i Komunës së Tuzit, si Themelues:

- miraton aktin e themelimit, ndryshimet dhe plotësimet e aktit të themelimit të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për Statutin e Shoqërisë;
- shqyrton raportin nbi punën dhe sjell Vendimin mbi shpërndarjen e profitit;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordi të drejtorëve;
- sjell vendimin mbi ndryshimin e formës, ristrukturimin dhe likuidimin vullnetar të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për ndryshimin e emërimit, veprimtarisë, selisë dhe kapitalit themelor të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për çmimorën e shërbimeve, të cilën e përcakton Bordi i drejtorëve;
- kryen veprime të tjera në pajtim me ligjin, Vendimin mbi themelim dhe Statutin.

Organe e Shoqërisë janë Bordi i drejtorëve si organ i drejtimit dhe Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes i Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve:

- drejton Shoqërinë dhe jep udhëzime drejtorit ekzekutiv në aspektin e udhëheqjes së punëve të Shoqërisë;
- sjell Statutin e Shoqërisë, me pajtim të themeluesit;
- emëron drejtorin ekzekutiv;
- i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues;
- përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe sjell akte për zbatimin e saj në pajtim me udëzimet e themeluesit;
- kryen mbikëqyrjen e udhëheqjes së Shoqërisë;
- sjell planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor mbi realizimin e planit vjetor të punës si dëshmisë financiare;
- përcakton çmimorën për kryerjen e shërbimeve të Shoqërisë, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
- sjell aktin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në pajtim me Kryetarin e Komunës;
- përcakton politikën e kontabilitetit të Shoqërisë dhe politikës së menaxhimit të rizikut;
- jep dhe shkarkon prokurën;
- miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv mbi veprimtarinë e Shoqërisë;
- sjell Rregulloren e procedurave mbi punën e Bordit të drejtorëve;

- kryen detyra tjera në pajtim me ligjin dhe Statusin e Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve përbëhet nga pesë (5) anëtarë, që janë përfaqësuesit e Themeluesit.

Drejtori ekzekutiv, si organ i udhëheqës së Shoqërisë kryen këto detyra si në vijim:

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë;
- lidh kontrata në emër të Shoqërisë;
- organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë;
- menaxhon pasurinë e Shoqërisë;
- zbaton vendimet e Shoqërisë;
- vendos mbi dispozicionin e mjeteve financiare të Shoqërisë;
- propozon programe dhe plane në fushat për të cilat është themeluar Shoqëria;
- përgatit propozon e planit vjetor të punës dhe planin financiarë të Shoqërisë;
- përgatit raportin vjetor mbi realizimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë si dhe dëshminë financiare;
- vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtim me ligjin;
- kryen dhe detyra të tjera lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë, në pajtim me ligjin, me Vendimin mbi themelim dhe me Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria është e obliguar që ta informojë vazhdimisht themeluesin dhe subjektet tjera që shprehin interes ligjor për përcjelljen e punës dhe funksionimin e saj.

III KAPACITETET E USHTRUESIT TË VEPRIMTARISË KOMUNALE

III/1 Resurset njerëzore

Aktualisht, në Shoqëri janë të angazhuar 38 ekzekutues.

Nga numri i përgjithshëm i personave të punësuar, 9 (nëntë) prej tyre janë marrë me marrëveshje nga ndërrmarjet tjera (përkatësisht nga shpk "Pijace i tržnice" Podgoricë dhe shpk "Komunalno/Kumanale" Tuz).

Nëse do të ketë rritje në vëllimin e punës gjatë vitit 2023, Shoqëria do të angazhoj një numër shtesë ekzekutuesish, në përputhje me rregulloret pozitive shtetërore dhe aktet e Shoqërisë.

III/2 Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Me qëllim të zbatimit të veprimtarisë komunale të Ushtruesit, veprimtarinë komunale, për të cilën është themeluar, do t'i kryejë në objektet që vijojnë:

Objektet	Adresa
----------	--------

1. Tregu i gjelbër	Tuz p.n.
2. Tregu i mallrave të përzier	Tuz p.n.

Tregu i mallrave të përzier ka në dispozicion 348 hapësira afariste - të tregut dhe 50 lokacione.

Tregu i gjelbër ka në dispozicion 25 vende të shitjes, një sektor për djathë dhe mish, 6 vende të shitjes për peshk. Në kuadër të tregut të gjelbër ekziston edhe lokali afarist, të cilin Shoqëria e jep në qira.

III/3 Pajisjet dhe parku i makinave

Shoqëria ende nuk ka pajisje të përcaktuara, përveç pajisjeve që gjenden në tregje, si dhe as veturë zyrtare.

IV QËLLIMET E SHOQËRISË

IV/1 Përmirësimi i krejt veprimtarisë

Qëllimet e Shoqërisë do të orientohen në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve të tregut. Me mirëmbajtje e objekteve dhe higjienës së tregut do të garantohet vend i sigurt dhe të parrezikshëm për kryerjen e punëve të besuara.

Në zonën e Tuzit ekziston edhe një numër i madh i ekonomive bujqësore, që tepricat e prodhimeve të veta i plasojnë në tregun e gjelbër, që është i njohur si vend ku mund të gjenden prodhimet vendore. Gjithashtu edhe tregu i mallrave të përzier është i njohur për numrin e madh të vizituesve dhe si vend i tregtisë së llojlojshme, për këtë arsye një numër i madh i qytetarëve nga komunat fqine vizitojnë objektet tona të tregut. Lidhur me këtë, Shoqëria do të ketë si qëllim avancimin e kushteve të punës në tregje si dhe për punën e saj të njihet si ndërmarrje që do të kryejë me sukses veprimtarinë me interes publik.

Me organizimet e planifikuara, në vitin 2023 Shoqëria do të angazhohet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e plotësisht të kapaciteteve të tregut.

Shoqëria ka për qëllim gjithashtu harmonizimin dhe hartimin e dokumenteve të reja normative të tij me rregulloret ligjore që lidhen me veprimtarinë e saj, si dhe harmonizimin e veprimtarisë me rregulloret ligjore në fuqi në fushën e veprimtarisë komunale dhe marrëdhënieve të punës.

Më në fund, qëllimi dhe detyra e Shoqërisë është të ruajë likuiditetin aktual dhe aftësinë paguese të saj, të rrisë nivelin e faturimit për shërbimet dhe të zgjidhë kërkesat nga përdoruesit e shërbimeve, të gjitha me qëllim të përmirësimit të veprimtarisë për të cilën Shoqëria është themeluar.

IV/2 Realizimi i bashkëpunimit me organët, shërbimet publike dhe organizatat e tjera që kanë ndikim në zbatimin e këtij Programi

Për realizimin efikas dhe me sukses të detyrave programore është e nevojshme të vazhdohet bashkëpunimi me Komunën e Tuzit si themelues i Shoqatës në aspektin e arritjes së qëllimeve programore të kësaj Shoqërie, si dhe me Kryetarin dhe Kuvendin të Komunës së Tuzit përmes dhënies së pëlqimit për vendimet e organeve drejtuese, si dhe me të gjitha organet e administratës lokale dhe organet e tjera kompetente, përkatësisht me:

- Sekretariatit për Zhvillim Ekonomik (si organ mbikëqyrës i administratës lokale që jep mendim dhe pëlqim për akte të caktuara të Shoqërisë);
- Me të gjitha kompanitë afariste dhe shërbimet tjera publike, themelues i të cilave është Komuna e Tuzit;
- Si dhe me autoritetet e tjera përkatëse shtetërore dhe vendore.

V BAZAT PËR PËRPILIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i Programit për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2023 bazohet në Rregulloren mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20) si dhe në bazë të të ardhurave dhe daljeve të planifikuara.

VI PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT FIZIK

- **Të ardhurat e planifikuara në Tregun e mallrave të përzier në bazë të kontratave qiraje**

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2023
Vendet e shitjes / Tezgat	123	212.024,00
Lokacionet	42	110.976,00
Gjithsejtë	165	323.000,00

- **Të ardhurat e planifikuara në Tregun e gjelbër në bazë të kontratave qiraje**

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2023
Tezgat	18	10.800,00
Spektori i peshkut	4	600,00
Hapësira afariste	1	3.600,00
Gjithsejtë	23	15.000,00

- Të ardhurat e planifikuara në Tregun e mallrave të përzier në bazë të pagesës ditore

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2023
Vendet e shitjes / Tezgat	70	72.000,00 (pagesa ditore mesatare 197,00)
Platoja per m/gjatesi	55	28.000,00
Gjithsejtë	125	100.000,00

VII TREGUESIT E PLANIFIKUAR FINANCIARË

Në pjesën e mëposhtme vijon një paraqitje tabelare e planit financiar për vitin 2023 me shpjegime, dmth. me strukturë të tyre.

VII/1 Të ardhurat e planifikuara për vitin 2023

TË ARDHURAT		
64	1. TË ARDHURAT NGA PREMITE, SUBVENCIONET, DOTACIONET, DONACIONET ETJ.	
6402	Të ardhurat nga donacionet (transferet nga buxheti i Komunës)	52.100,00
	NË TOTAL 1	52.100,00

61	2. Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në tregun e brndshëm	
6122	Të ardhurat nga shërbimet për personat fizikë dhe juridikë në vend	453.000,00
	NË TOTAL 2:	453.000,00
	TË ARDHURAT TOTALE	505.100,00

VII/2 Shpenzimet e planifikuara për vitin 2023

Kostoja e materialeve

	VI-2 Paraqitja analitike e shpenzimeve	PLANI 2023
	SHPENZIMET	
27	TAKSA MBI VLERËN E SHTUAR	60.000,00
	Detyrimet mbi TVSH-në	60.000,00
46	DETYRIMET TJERA	4.820,00
469	Detyrimet tjera	4.820,00
51	II SHPENZIMET MATERIALE	52.000,00
5120	Kostot e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës	2.000,00
5121	Kostot e materialeve për zyre	2.000,00
5123	Kostot për mirëmbajtjen e tregut dhe stadiumit të qytetit	3.000,00
513	Shpenzimet e karburantit	10.000,00
5130	Shpenzimet e energjisë elektrike	35.000,00

52	III SHPENZIMET E PAGAVE, KOMPENSIMI I PAGAVE DHE SHPENZIMET E TJERA PERSONALE	297.580,00
5200	Kostot neto të pagave për punë të rregullt	220.880,00
5201	Kostot e tatimit mbi pagën dhe kompensimi i pagave që përballohen nga punonjësi	1.440,00
5207	Kostot e kontributeve të pagave dhe tarifat e pagave që përballohen nga punëdhënësi	59.300,00
5208	Kostot e kontributeve të pagave dhe tarifat e pagave të ngarkuara nga punëdhënësi	3.240,00
5210	Kostot e taksimit mbi tatim	420,00

5220	Kostot e kompensimit sipas kontratës së punës	6.000,00
5260	Pagesa për anëtarët e Bordit të drejtorëve	6.300,00

Kostot e shërbimeve të prodhimit

53	IV KOSTOT E SHËRBIMEVE TË PRODHIMIT	55.700,00
5321	Kostot e shërbimit të riparimit të pajisejve	2.500,00
5322	Kostot e mirëmbajtjes së vazhdueshme të objektit dhe terrenit të stadiumit të qytetit	3.300,00
5334	Kostot e qirasë së objektit afaristë	32.400,00
5312	Shërbime të komunikimit	6.000,00
539	Shërbime të tjera	9.000,00
5391	Katalogu i rregulloreve	500,00
5392	Kostot e shërbimit të dezinfektimit, dezinfektimit...	2.000,00

Shpenzimet jomateriale dhe kostot tjera

55	V SHPENZIMET JOMATERIALE	28.500,00
5510	Kostot e përfaqësimit, shtypit dhe bifës	4.000,00
5524	Kostot e sigurimit të punonjësve gjatë punës	500,00
5530	Shërbimet bankara/provizjonet	1.000,00
5592	Kostot e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së softverit	3.000,00
	Shpenzimet për shërbimet komunale	20.000,00
57	VI SHPENZIMET TJERA	6.500,00
5794	Kostot e blerjes së pajisjeve për nevojat e FK Deçiq	1.000,00
57944	Kostot për pesticidë	5.500,00

PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2023

VI PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2023	2023
TË ARDHURAT TOTALE TË PLANIFIKUARA	505.100,00
SHPENZIMET TOTALE TË PLANIFIKUARA	505.100,00
FITIMI/HUMBJA	0,00

BURIMET FINANCIARE

Burimet financiare janë:	2023
BURIMI I TË ARDHURAVE	SHUMA
Mjetet nga buxheti i Komunës	52,100,00
Të ardhurat e planifikuara nga burimet vetanake	453,000.00
GJITHSEJ:	505,100.00

VII/3 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2023, pritet që të arrihet poziviteti afarist prej 0,00 euro.

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2023, Shoqëria planifikon të ardhurat me vlerë prej 505,100.00 euro.

Të ardhurat janë planifikuar në bazë të të ardhurave të realizuara të Shoqërisë në vitin 2022 dhe rritjes së planifikuar në vitin 2023.

Në pozicionin numër 1, grupi i llogarisë 61 - të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në tregun e brendshëm në vlerë prej 453,000,00€ përbëhen nga:

Ofrimi i shërbimeve në Tregun e mallrave të përzier/pagesat ditore;
- të ardhura të planifikuara prej 100,000,00€

Të ardhurat në Tregun e mallrave të përzier në bazë të marrëveshjes së qirasë;
- të ardhura të planifikuara 323,000,00€

Të ardhura nga Tregu i gjelbër në bazë të marrëveshjes së qirasë;
- të ardhura të planifikuara 15,000,00€

Të ardhura nga qiraja për shfrytëzimin e hapësirës personave të tjerë juridikë;
- të ardhura të planifikuara 15,000,00€

Në pozicionin numër 2, grupi i llogarisë 64, të ardhura nga primet, subvencionet, dotacionet, donacionet etj. në vlerë prej 52,100,00€, përbëhen nga:
- të ardhura nga donacionet (transferta nga buxheti i Themeluesit, Komuna e Tuzit), 52,100.00€.

Me programin e kryerjes së aktiviteteve komunale për vitin 2023, Kompania planifikon shpenzime totale në vlerë prej 505,100,00€.

Llogaria e grupit 27, tatimi mbi vlerën e shtuar, është planifikuar në vlerë prej 60,000,00€

Llogaria e grupit 46, detyrimet tjera në vlerë 4,820,00€ përbëhet nga:

- detyrime të tjera nga viti 2022. në vlerë prej 4,820,00€

Llogaria e grupit 51 në vlerë prej 52,000,00€ përbëhet nga:

- shpenzimet e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës në vlerë prej 2000,00€
- shpenzimet e materialeve të zyrës në vlerë prej 2,000€,
- shpenzimet për mirëmbajtjen e tregut dhe stadiumit të qytetit në vlerë prej 3000,00€
- shpenzimet e karburantit dhe lubrifikantit në vlerë prej 10,000,00€,
- shpenzimet e energjisë elektrike në vlerë 35.000€.

Llogaria e grupit 52 përbëhet nga shpenzimet e pagave bruto prej 297,580.00€.

Struktura e këtyre kostove është e detajuar në planin financiar. Shpenzimet nga ky grup janë planifikuar në bazë të numrit të punëtorëve që janë të nevojshëm për qëndrueshmërinë dhe procesin e punës së kësaj Kompanie.

Llogaria e grupit 53, kostot e shërbimeve të prodhimit në vlerë 55,650,00€ përfshijnë:

- shpenzimet e shërbimeve të riparimit për mirëmbajtjen e pajisjeve të stadiumit të qytetit në vlerë prej 2,500,00€
- shpenzimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme të objektit dhe terrenit të stadiumit të qytetit në vlerë prej 3,300.00€.
- shpenzimet për qirat që shfrytëzon Shoqëria në vlerë prej 32,400,00€,
(-qira për objektin e Tregut të Gjellbër 24,000,00€),
(-qira për zyrat e Shoqërisë 8,400.00€)
- shpenzimet e shërbimeve të komunikimit në vlerë prej 6,000,00€
(-mirëmbajtja e arkës fiskale 300,00€),
(-rrjeti i telefonisë celulare 3000,00 €)
(-shërbimet e internetit 2,700,00 €)
- shërbime tjera në vlerë 9000,00€
- shpenzimet për katalogun e rregulloreve në vlerë prej 500,00€
- shpenzimet e shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit... në vlerë prej 2,000.00€.

Llogaria e grupit 55, shpenzimet jomateriale në vlerë prej 28,500,00€

- shpenzimet e përfaqësimit, shtypit ditor dhe shpenzimet e bifes në shumën 4000.00€
(-kapsula kafeje 800,00 €)
(-shpenzimet e përfaqësimit dhe bifes, 830,00 €)
(-publikimet dhe shtypi ditor 370,00 €)
(-drekat e punës 2000,00 €)
- shpenzimet e sigurimit të punonjësve gjatë punës në vlerë prej 500,00€
- kosto për shërbimebankare/provizjone në vlerë 1,000,00€
- shpenzimet e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së softverit në vlerë prej 3,000,00€
- shpenzimet e shërbimeve komunale në vlerë prej 20,000,00€
(-deponimi i mbeturinave komunale 16,885,00€)
(-shpenzimet për ujë nga rrjeti i ujësjellësit 3,115,00 €)

Llogaria e grupit 57, shpenzime tjera në vlerë 6500,00€

- shpenzimet e blerjes së pajisjeve për nevojat e FK Deçiq në vlerë prej 1,000.00€.

-shpenzimet për blerjen e pesticideve në vlerë prej 5,500.00€

Shpenzimet janë planifikohen sipas aktiviteteve programore të Shoqërisë dhe kostove të pritshme që janë të nevojshme për funksionimin normal të saj.

VIII POLITIKA E RROGAVE DHE PUNËSIMIT

- Tabelat 1 dhe 2, të cilat vijojnë në tekstin e Programit, përcaktohen si përmbajtje e detyrueshme të Programit, në përputhje me pikën 10 të shtesës 1 të Rregullores (politika e pagave dhe punësimit) mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale.

Tabela 1. Struktura e punonjësve sipas formimit profesional, d.m.th. nivelit e kualifikimit të arsimit

LLOJI I PUNËS	VI, VII nivel ose më shumë	IV nivel	III nivel	I1 ose I2 nivel	PK
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	3				
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE	1	1			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	2				
PUNËT JURIDIKE	1				
VEPRIMTARIA THEMELORE	1	7	2	1	2
MIRËMBAJTJA				2	4
VEPRIMTARIA DYTËSORE		1		1	

PUNËT LOGJISTIKE			3	6	
GJITHSEJIT - 38	8	9	5	10	6

Tabela 2 . Struktura e punonjësve sipas moshes

LLOJI I PUNËS	18 - 25	26 - 34	35 - 45	46 - 55	56 - 64	Mbi 65
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	3					
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE	1	1				
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	2					
PUNËT JURIDIKE	1					
VEPRIMTARIA THEMELORE	1	7	2	1	2	
MIRËMBAJTJA				2	4	
VEPRIMTARIA DYTËSORE		1		1		
PUNËT LOGJISTIKE			3	6		
GJITHSEJIT - 38	8	9	5	10	6	

- Numri total i të punësuarve tregon faktin se në këtë Shoqëri përqindja e pjesëmarrjes së pjesës administrative të punonjësve është 21%, që është më pak se mesatarja në nivel të shtetit që kalon mbi 25 %.

IX BORXHI

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2023, Ushtruesi nuk planifikon borxh kreditor.

X PLANI I PROKURIMIT PUBLIK

Plani vjetor i Prokurimit Publik të Shoqërisë për vitin 2023 do të hartohet në përputhje me afatet e Ligjit mbi Prokurimin Publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19) dhe në përputhje me Rregulloren për formën e planit të prokurimit publik ("Fleta zyrtare e MZ" nr. 55/20).

Në pjesën e akteve nënligjore veçojmë disa akte kryesore, në bazë të të cilave Shoqëria do të kryejë prokurimin publik në vitin 2023:

- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së prokurimit të thjeshtë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 61/20);
- Rregullorja për listën e punëve dhe procedurave që mund të jenë objekt i prokurimit publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 57/20);
- Rregullorja për mënyrën e planifikimit dhe zbatimit të prokurimit publik të centralizuar ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 69/20).

NË TABELËN QË VIJON PARAQITET PLANI I PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023

N.r.	Përshkrimi	Vlera e parashikuar duke përfshirë TVSH-në	Lloji i procedurës së prokurimit publik
I PLANI PËR MALLRA			
1.	Mjetet për mirëmbajtjen e higjienës	2,000.00	Prokurim i thjeshtë
2.	Materialet për zyre dhe matarialet tjera administrative	2,000.00	Prokurim i thjeshtë
3.	Reprezentacija i troškovi bifea	830.00	Prokurim i thjeshtë
4.	Kapsula kafeje	800.00	Prokurim i thjeshtë
5.	Publikimet dhe shtypi ditor	370.00	Prokurim i thjeshtë

6.	Mjetet për mirëmbajtje e tregut dhe stadiumit të qytetit	3,000.00	Prokurim i thjeshtë
7.	Karburant	10,000.00	Prokurim i thjeshtë
8.	Prokurimi i pajisjeve për nevojat e FK Deçiq	1,000.00	Prokurim i thjeshtë
9.	Pesticidet	5.500,00	Prokurim i thjeshtë
I	VLERA TOTALE PËR MALLRA	25,500.00	
II PLANI PËR SHËRBIME			
10.	Mirëmbajtja e vazhdueshme e riparimit - pajisjeve	2.500,00	Prokurim i thjeshtë
11.	Mirëmbajtja e vazhdueshme e objektit dhe terrenit të stadiumit të qytetit	3.300.00	Prokurim i thjeshtë
12.	Shërbimet të komunikimit	6,000.00	Prokurim i thjeshtë
13.	Shërbime të tjera	4,000.00	Prokurim i thjeshtë
14.	Katallogu i rregulloreve	500.00	Prokurim i thjeshtë
15.	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softverit	3,000.00	Prokurim i thjeshtë
16.	Përfaqësimet - drekë pune	2,000.00	Prokurim i thjeshtë
17.	Sigurimi i punonjësve	500.00	Prokurim i thjeshtë
18.	Hartimi i planit për mbrojtje në punë	5,000.00	Prokurim i thjeshtë
19.	Shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit...	2,000.00	Prokurim i thjeshtë
II	VLERA TOTALE PËR SHËRBIME	28,800.00	
	VLERA TOTALE (I+II)	54,300.00	

Vërejtje *: Plani i prokurimit publik i paraqitur në tabelë mund të ndryshohet, pasi që brenda afatit ligjor, domethan deri më datën 31.01.2023, do të aprovohet Plani i prokurimit publik i Shoqërisë për vitin 2023 dhe do të silllet Vendimi për miratimin e tij.

XI POLITIKA E ÇMIMEVE

Çmimorja e shërbimeve të Shoqërisë është përcaktuar dhe miratuar me Vendimin e Bordit të drejtorëve të Shoqërisë nr. 16/21 prej më 21.12.2021, për të cilin Kuvendi I Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin nr. 02-030/21-15722 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21, prej më 30.12.2021).

Në bashkëpunim me Themeluesin, duhet të përcaktojmë mënyrën e veprimit në të ardhmen, në mënyrë që të mos rrezikojmë funksionet bazë të veprimtarisë, dhe njëkohësisht të mbrojmë interesin publik nëpërmjet kryerjes së vazhdueshme të veprimtarive komunale.

XII VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Ky Program ofron një pasqyrë të drejtimeve bazë strategjike dhe aktiviteteve të planifikuara me një vlerësim real të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore që mundësojnë realizimin e detyrave për të cilat është themeluar Shoqëria.

Realizimi i aktiviteteve të përcaktuara me këtë Program kërkon përmirësimin e kushteve të punës, angazhimin e fuqisë punëtore profesionale, si dhe modernizimin e mëtejshëm të organizimit të punës.

Rrjedhimisht, Shoqëria do të vazhdojë me mirëmbajtjen cilësore dhe të vazhdueshme të objekteve të tregut dhe kryerjen e detyrave të tjera për të cilat është themeluar, duke u kujdesur që të sigurojë interesin publik dhe stabilitetin e veprimtarisë.

Në fund, duhet theksuar se si shërbim publik, ne llogarisim në bashkëpunim dhe ndihmën e Themeluesit, për të arritur qëllimet dhe aktivitetet programore, në mënyrë sa më efektive.

Siç e kemi paraqitur në pjesën financiare të këtij Programi, pritet pozitivitet afarist i Shoqërisë dhe realizimi i fitimit prej 0.00 euro.

DREJTORI EKZEKUTIV

Ruzhdi Lluka



Dorëzuar:

- Shërbimit të Kryetarit të Komunës
- Sekretariatit për zhvillim ekonomik
- Arkivit të Bordit të drejtorëve
- a/a